

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga MOTOR OIL (HELLAS) CORINTH REFINERIES S.A., me seli të regjistruar në 12A Irodu, Atiku, 15124 Marousi, Atikë, Greqi, të dorëzuar përmes Jane Ilijeski, avokat nga Shoqëria e Avokatëve ÇOKU dhe Partnerët nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 20.05.2026, miratoi këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin MOTOR OIL (HELLAS) CORINTH REFINERIES S.A., me seli të regjistruar në 12A Irodu, Atiku, 15124 Marousi, Atikë, Greqi, synon të fitojë kontroll të vetëm mbi ATLANTIS S.A., me seli të regjistruar në Moli e 6-të në Portin e Selanikut, Greqi, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në vlerë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në vlerë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksat administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra e të ardhurave dhe programi 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 20.04.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua njoftim për përqendrim nga MOTOR OIL (HELLAS) CORINTH REFINERIES S.A., me seli të regjistruar në 12A Irodu, Atiku, 15124 Marousi, Atikë, Greqi, me të cilin MOTOR OIL (HELLAS) CORINTH REFINERIES S.A. synon të fitojë kontroll të vetëm mbi ATLANTIS S.A., me seli të regjistruar në Molin e 6-të në Portin e Selanikut, Greqi, përmes fitimit të 70% të kapitalit themelor të emetuar dhe të regjistruar të shoqërisë së synuar, pas rritjes së kapitalit themelor.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimin të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në njoftimin për përqendrim dhe dokumentacionit të bashkëngjitur, konstatoi si vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

MOTOR OIL (HELLAS) CORINTH REFINERIES S.A. është shoqëria udhëheqëse e shoqërive të Grupit Motor Oil („Grupi Motor Oil“) dhe është aktive, drejtpërdrejt ose tërthorazi, përmes shoqërive të saj të varura, në këto fusha:

- rafinimin (kryesisht të naftës së papërpunuar) dhe prodhimin e produkteve të naftës (për ngrohje, industrinë automobilistike dhe detare), si dhe të produkteve të tjera të naftës (vajra bazë, lubrifikantë, bitum, gaz i lëngshëm i naftës (LPG), karburant aviacioni (jet fuel), mazut dhe benzinë) dhe produkteve kimike;
- tregtinë me shumicë dhe pakicë të produkteve të naftës në Greqi dhe jashtë saj;
- menaxhimin dhe operimin e objekteve të naftës;
- menaxhimin e sistemit të furnizimit dhe magazinimit të karburantit për avionë në Aeroportin Ndërkombëtar të Athinës „Eleftherios Venizelos“;
- prodhimin dhe furnizimin me energji elektrike;
- importin dhe furnizimin me gaz natyror; dhe
- transmetimin radiofonik dhe televiziv.

MOTOR OIL (HELLAS) CORINTH REFINERIES S.A. ka prani të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërive të saj të varura indirekte:

- **KORAL-FUELS SHPKNJP Shkup**, me seli të regjistruar në rr. „Dimitrie Çupovski“ nr. 4-2/3, Shkup – Qendër, Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, me veprimtari prioritare të regjistruar 47.300 – shitja me pakicë e karburanteve dhe lubrifikantëve; dhe
- **MOTOR OIL RENEWABLE ENERGY SHPKNJP Shkup**, me seli të regjistruar në rr. „Georgi Dimitrov“ nr. 13/1-3, Kisella Vodë, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, me veprimtari prioritare të regjistruar 35.150 – Tregtia me energji elektrike.

ATLANTIS S.A. është një shoqëri greke e themeluar në vitin 1993, e cila është aktive në tregjet e bitumit dhe karburanteve. Kryesisht, ATLANTIS S.A. ushtron këto veprimtari afariste:

- shitjen me shumicë të bitumit standard;
- zhvillimin, prodhimin dhe shitjen me shumicë të polimereve të modifikuara dhe bitumit të modifikuar;
- shitjen me shumicë të karburanteve industriale, karburanteve për ngrohje dhe karburanteve të transportit;
- shitjen e produkteve për hidroizolim (mjete izoluese) për ndërtesa, tunele dhe sektorin e ndërtimtarisë.

ATLANTIS S.A. nuk ka shoqëri të varura të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por ka realizuar të ardhura në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes shitjes me shumicë të bitumit standard te tregtarët lokalë (rishitësit).

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i paraqitur, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ